

## **PROCESVERBAL**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Zgjerimi i sallës së monitorimit dhe dispecerise qendrore”.**

#### **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Kompjutera desktop 30213300-8  
Furnizime elektronike 31711000-3  
Karrige me rrota 33193120-6  
Tavolina 39121200-8  
Dollapë 39122100-4

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

- **9,368,420.00 (nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e katërqind e njëzet) lekë, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor – Autoriteti Portual Durrës – ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas shtojcës 8, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe shtojcës 9 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një mënyrë të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

### **Argumentimi:**

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenet 40, pika 4 e 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

### **2.3.2. Operatori Ekonomik pjesmarres duhet të jete i certifikuar sipas ISO 9001; ose ekuivalent.**

Per plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesit duhet të paraqesin Certifikatën ISO 9001 e cila duhet të jete per te njejten fushe me kategorine dhe specifiken e produkteve/shërbimeve qe prokurohen. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Duke qene se paisjet e kerkuara jane per sistem sigurie si dhe teknologjia e kerkuar eshte e nje niveli te larte duhet qe subjektet zbatuese te kontrates te jene te pajisura me keto certifikime.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

*Përmbushja e standartit ISO 9001 ose ekuivalent është i rendesishem per te siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.*

### **2.3.3. Operatori Ekonomik pjesmarres duhet te jete i certifikuar sipas ISO 27001; ose ekuivalent.**

Per plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesit duhet te paraqesin Certifikaten ISO 27001 e cila duhet te jete per te njejten fushe me kategorine dhe specifiken e produkteve/shërbimeve qe prokurohen. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

*Duke qene se paisjet e kerkuara jane per sistem sigurie si dhe teknologjia e kerkuar eshte e nje niveli te larte duhet qe subjektet zbatuese te kontrates te jene te pajisura me keto certifikime.*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.*

*Certifikimi ISO 27001 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar qe OE është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës duke siguruar qe informacionet te menaxhohen në mënyrë të sigurtë dukeqenese sistemi perpunon dhe administron informacione dhe te dhena te rendesishme dhe sensitive . Ky certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet nderkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës.*

**2.3.4** Operatori Ekonomik ofertuese duhet te jete i autorizuar per furnizimin dhe suportin per pajisjet e ofruara, per kete duhet te paraqesin Autorizimin nga prodhuesi / Distributori i autorizuar nga prodhuesi ( ne rastin e distributorit te autorizuar duhet te paraqitet dokumenti

qe verteton lidhjen midis Prodhuesit dhe distributorit) per furnizimin dhe suportin ne territorin e Shqiperise te pajisjeve :

- Workstation
- License per shtese kamerash

Ky autorizim duhet te jete i leshuar per objektin e tenderit dhe per autoritetin kontraktor

**Argumentimi:**

*Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar te origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në kete prokurim, garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar per territorin e Shqiperise për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanton qe produktet që kërkohen të blihen janë prodhuar/krijuar sipas standardeve të larta nga prodhues të njohur zyrtarisht. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor per tu garantuar qe Operatori Ekonomik ka mbeshtetjen dhe suportin e prodhuesit per te garantuar cilesine e produkteve dhe furnizimin e tyre ne kohe për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e pajisjeve ne kushtet e garancisë dhe pas saj.*

*Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të dëshmoje qe ka stafin e nevojshem teknik të kualifikuar për realizimin e kontrates .

Per kete duhet te kete ne përbërje të stafit :

- a) Minimalisht 1 (nje) punonjes te certifikuar nga Prodhuesi per Ndertimin e Sistemeve te Integruara. Per kete duhe te paraqese certifikaten perkatese dhe duhet te jete ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

**Argumentimi:**

*Eshte kerkuar ky kriter pas eshte shume i rendesishem per faktin se sistemi ku do te implementohen paisjet e kerkuar eshte nje sistem i integruar me sisteme dhe paisje te ndryshme duke e bere nje sistem kompleks dhe shume sensitiv dhe qe kerkon kualifikim te larte te konfirmuar nga prodhuesi per venien ne pune dhe integrimin e tij ne menyre teresisht funksionale me produktet e ofertuara.*

- b) Minimalisht 1 punonjes te certifikuar nga prodhuesi per Sistemet e Menaxhimit Video . Per kete, duhet te paraqese certifikaten perkatese dhe duhet te jete ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

*Argumentimi:*

*Ky kriter është shumë i rëndësishëm pasi sistemi menaxhohet dhe administrohet nga një platforme shumë e lartë e cila kërkon njohje shumë të mira dhe të konfirmuar nga prodhuesi për të garantuar një menaxhim të mirë të sistemit video .*

- c) Minimalisht 1 (një) punonjës që është i certifikuar për Sigurinë Kibernetike .Për këtë, duhet të paraqesë certifikatën përkatëse dhe duhet të jetë në listëpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit.

**Argumentimi:**

*Pajisjet e kërkuara dhe sistemi ekzistues prodhojnë ,transmetojnë dhe administrojnë informacione të rëndësishme dhe sensitive të cilat kërkojnë një sistem dhe administrim të sigurtë të të gjitha të dhënave. Me këtë kriter kërkohet të garantohet siguria e informacionit nga ndërhyrje kibernetike të qëllimshme apo aksidentale.*

- d) Minimalisht 1 (një) punonjës që është i certifikuar për rrjetet IP (Network ) certifikata CCNA ose ekuivalent . Për këtë, duhet të paraqesë certifikatën përkatëse dhe duhet të jetë në listëpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit.

**Argumentimi:**

*Pajisjet e kërkuara do të implementohen në sistemin e sigurisë ekzistuese, i cili ka një rrjet komunikimi network të zgjeruar dhe shumë cilesor i cili kërkon kompetenca të larta teknike për konfigurimin administrimin dhe monitorimin e rrjetit network .*

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

**2.3.6** Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike të ngarkuar në SPE nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës.Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

- a. Emri i kompanisë prodhuese ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit.Adresa dhe web-sit të saktë të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.
- b. Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.
- c. Nr.i faqes në katalog referuar Nr.Idetifikues të artikullit të ofruar sipas listës i shënuar me një shenjë dalluse.

**Argumentim:** Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

- **Kerkoet garancia per 1 vit per produktet si me poshte:**

1	Workstation	Cope	4
2	Monitor 24"	Cope	4
3	Telefona Cisco	Cope	3
4	Switch 24 porta PoE (per ndarjen e rrjetit)	Cope	1
5	SWITCH PoE 4 PORTA PoE+, 1 SFP	Cope	3
6	Workstation	cope	1
7	PC	cope	3
8	Monitor 24"	cope	4

**Afati i l vrimitt t  produkteve do t  jet  90 dit  q  nga data e n nshkrimit t  kontrat s, dhe kjo eshte kontrate furnizim vendosje.**

**T  gjith  dokumentat duhet t  jen  origjinal  ose kopje t  noterizuara t  tyre. Rastet e mosdor zimit t  nj  dokumenti, ose t  dokumentave t  rreme e t  pasakta, konsiderohen si kushte p r skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike jan  hartuar duke marr  n  konsiderat , p r blerjet e reja cil sore, k rkesat aktuale p r funksionalitet zgjerim cil si e p rformanc  si dhe sh rbimet profesionale t  k rkuara p r teknologjite ekzistuese, ofrimit t  produkteve t  reja, karakteristikat e duhura bashk kohore teknologjike, standardet e duhura komb tare dhe nd rkomb tare, n  p rputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, t  Ligjit Nr. 162, dat  23.12.2020 "P r prokurimin publik", si dhe nenit 40, pika 2, t  VKM nr. 285, dat  19.05.2021, "P r miratimin e rregullave t  prokurimit publik". N   do rast ku ka qen  e mundur  sht  p rdorur termi "ose ekuivalent" p r t  qen  gjithmon  n  konformitet me zbatimin e legjislacionit t  prokurimeve publike dhe akteve n n-ligjore n  zbatim t  tyre.*